



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 196, Datë 13.07.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 91, DATË 02.04.2026
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DION ENERGJI” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/4 prot., datë 09.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 02.04.2026 “Mbi licencimin e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW”, i ndryshuar,

Konstatohet se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 02.04.2026, i ndryshuar me vendimin nr. 152, datë 28.05.2026, vendosi të licencojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1693/3 prot., datë 30.06.2026, shoqëria ka depozituar të gjithë praktikën e ndjekur dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me testimin e veprës, sikurse përcaktuar në nenin 10 të Kontratës nr. 1980 rep., nr. 1272 kol., datë 06.04.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me depozitimin e dokumentacionit përkatës të testimit të veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 91/2026, i ndryshuar, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 3 të këtij vendimi është plotësuar, ndaj vlerësohet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3 të vendimit nr. 91/2026, i ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi si vijon: *Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 02.04.2026, i ndryshuar, si vijon:
 - a) Pika 3 e vendimi të bordit nr. 91, datë 02.04.2026, i ndryshuar, shfuqizohet.
 - b) Pika 4 ndryshon dhe bëhet:
 4. *Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, të njoftojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI